



Datë: 16.05.2025
Numër Protokolli: 3484/2025

A.nr.480/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.480/2025, të datës 17.03.2025, të parashtruar nga ankuesi H.G, kundër organit të punësimit/Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “*Vlerësim i rezultateve në punë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.480/2025, të datës 17.03.2025, e parashtruar nga ankuesi H.G, në atë mënyrë që **anulohet** Formuari i datës 28.02.2025, lidhur më vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2024.

II. Obligohet ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr. Ref.01/74 të datës 04.11.2024, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë rivlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për përdhën 04.11.2024 deri me 31.12.2024.

III. Obligohet ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, e caktuar sipas Vendimit me Nr. Ref.01/27 të datës 03.05.2024, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë vlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për përdhën 03.05.2024 deri 03.11.2024.

IV. Obligohet zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, i caktuar sipas Vendimit me Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi të bëjë vlerësim të rezultateve në punë për ankuesin për periudhën 01.01.2024 deri më datë 02.05.2024.

V. Obligohen Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që të ndërmarrin çdo veprim administrativ në kuptim të zbatimit të këtij vendimi sikurse është përcaktuar në pikën II, III dhe IV të këtij dispozitivi.

VII .Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil H.G (në tekstin e mëtejme referuar Ankuesja), më datë 17.03.2025 përmes emailit ankesa.kpmschck@rks-gobv.net, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 19.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (tutje referuar MINT), ndërsa kjo e fundit më datë 24.03.2025 ka dërguar përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave , vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1732/2025 e datës 17.03.2025 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 28.02.2025, 28.02.2024, 06.02.2023; Vendimin A.nr.136/2024 i KPMSHCK; Kopjen e ID-së së ankuesit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 19.03.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 24.03.2025; Akt Emërimit AE.Nr.24/2021 të datës 06.01.2021; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Drejtor i Departamentit për Rezervat Shtetërore të Mallrave datës 05.05.2017; Vendimin Ref.Nr.01/74 i datës 04.11.2024 për caktimin nëpunëses Q.A ushtrueses së detyrës së Sekretares së Përgjithshme të MINT; Ndryshimin dhe Plotësimin e aktit të emërimit i datës 09.02.2015 për nëpunësen Q.A; Vendimin me Nr. Ref.01/27 të datës 03.05.2024 për caktimin e nëpunëses civile S.B-I ushtruese e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të MINT; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 08.06.2018 për nëpunësen D.B-I; Vendimin Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023 për caktimin e nëpunësit D.L si zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT; Akt Emërimit e datës 05.09.2019 për nëpunësin D.L; Emailin e datës 22.01.2025 nga E.A për ankuesin; Emailin e darës 17.01.2025 nga B.Sh për A.Z, Z.S K.B; Vendimin e datës 28.04.2025 për shtyrjen e afatit për vendosje të ankesës së ankuesit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se sipas Akt Emërimit AE.Nr.24/2021 të datës 06.01.2021 mban pozitën e punës *Drejtor i Departamentit për Rezervat Shtetërore* në kudër të MINT.

Tutje, sipas shkresave të lëndës rrjedhë se ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 28.02.2025 ka bërë vlerësimin e rezultateve në punës për ankuesin për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024 dhe atë në nivelin e përgjithshëm të vlerësimit *Ka nevojë për përmirësim.*

Ankuesi, në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë të datës 28.02.2025, nga ushtruesja e detyrës së Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë për periudhën nga data 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, pretendon se vlerësimi është bërë nga personi i caktuar si ushtrues detyre i

Sekretares së Përgjithshme të MINT në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, vlerësimi është bërë në mënyrë tendencioze dhe me hakmarrje të qëllimshme.

Kolegji i Këshillit lidhur me vendosjen e kësaj çështje juridike administrative ju referua Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më theks të veçantë:

-Nenit 52: *1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësisë të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 8. Performanca e nëpunëses/it civil të kategorisë së ulët, të mesme dhe të lartë drejtuese, vlerësohet nga mbikëqyrësja/i i saj/tij i drejtpërdrejtë, udhëheqësja/i më i lartë administrativ dhe nga nëpunësit që ka në vartësi. 9. Përfundimisht, në rastin e ndërrimit të mbikëqyrëses/it përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secila/i mbikëqyrëse/ës vlerëson nëpunësen/in vetëm për periudhën përkatëse. 10. Përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, merr pjesë, mbështet dhe vëzhgon çdo proces të vlerësimit. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin. 12. Në fund të periudhës së vlerësimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore zhvillojnë takim me nëpunësen/in për vlerësimin e rezultateve të punës. Pas takimit, mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë aprovon formularin e vlerësimit që e nënshkruajnë të gjitha palët. 13. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 13.1. arritje e jashtëzakonshme; 13.2. tejkalon pritshmëritë; 13.3. arrin pritshmëritë; 13.4. ka nevojë për përmirësim; 13.5. e papranueshme.*

Kolegji i Këshillit për vendosja të drejtë mori parasysh edhe Rregulloren (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publik (në fuqi deri më datë 03.10.2024) dhe Rregulloren (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë (e cila është e aplikueshme nga data 04.10.2024), e të cilat akte ligjore rregullojnë procedurën e vlerësimit të rezultateve në punë.

Në ndërlidhje me pretendimet ankimore të ankuesit së nuk është vlerësuar për tërë vitin kalendarik, Kolegji i Këshillit konstaton së një pretendim i tillë është i bazuar, për faktin së sikurse përcaktohet me nenin 52 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, vlerësimi i rezultateve në punë përfshirë tërë vitin kalendarik nga data 01 janar deri 31 dhjetor, ndërsa, nga analizimi i aktit të kundërshtuar më ankesë del së ankuesi nuk është vlerësuar për tërë vitin 2024, por i njëjti është vlerësuar vetëm për periudhën 04.11.2024 deri më datë 31.12.2024, ndërsa, për pjesën paraprake të periudhës së vlerësimit edhe pse ka pasur dy mbikëqyrës nuk është vlerësuar, veprim ky që bie ndesh më dispozitat e Ligjit Nr.

08/L-197 për Zyrarët Publik, sepse është obligim ligjor që mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë të bëjë vlerësimin e rezultateve në punë për vartësit e tij në momentin e ndërrimit/përfundimit të mbikëqyrjes, e po ashtu është detyrim ligjor i Njësisë së Personelit që të përkujdeset që mbikëqyrësi të bëjë vlerësimin e stafit në përfundim të mbikëqyrjes, veprime këto të parapara me nenin 5 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë dhe nenit 10 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, ku përcaktohet se: 5. *Në rastet të ndërrimit të mbikëqyrësit përpara përfundimit të vlerësimit vjetor, secili mbikëqyrës vlerëson nëpunësin vetëm për periudhën përkatëse të mbikëqyrjes. NjMBNj siguron që mbikëqyrësi që ndërrohet, bën vlerësimin për periudhën përkatëse në përfundim të mbikëqyrjes.*

Andaj, duke qenë se ankuesi për periudhën e kundërshtuar të vlerësimit ka pas tre mbikëqyrës dhe atë nga data 01.01.2024 deri 02.05.2024, si mbikëqyrës ka qenë zyrtari D. L, i emëruar si zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të MINT sipas Vendimit me Ref.Nr.01/33 të datës 19.05.2023, të Ministres së MINT, nga data 03.05.2024 deri më datë 03.11.2024, si mbikëqyrës i ankuesit ka qenë zyrtarja Sh. I, e emëruar si u.d e Sekretarit të Përgjithshëm të MINT sipas Vendimit me Nr. Ref.01/27 të datës 03.05.2024, ndërsa, nga data 04.11.2025 deri më 31.12.2024, mbikëqyrës i ankuesit është zyrtarja Q. A, sipas Vendimit Ref.Nr.01/74 të datës 04.11.2024, kurse ankuesi ka vlerësim vetëm për periudhën 04.11.2024 deri 31.12.2024, andaj, Kolegji më qellim të kthimit të ligjshmërisë e në kuptim të dispozitave të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, 1.4 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht mbi këto shkaqe nuk ka trajtuar pretendimet referuar argumentit të vlerësimit.

Këshillë juridike: *Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.480/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit H.G;
- Organit të Punësimit: Sekretares së Përgjithshëm dhe Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore në MINT; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.